



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



16.06.2023

Nr. 05/266

Podujevë

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, neni 67, 68 dhe 69, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, në bazë të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.18/2009 Neni 8 Raporti nxënës-mësimdhënës dhe raporti-personel jo-mësimdhënës dhe si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në sektorin Publik ,Drejtoria e arsimit shpall:

K O N K U R S

Institucioni: Komuna e Podujevës;

Drejtoria: Drejtoria e arsimit;

Titulli i vendit të punës: Bibliotekist;

Numri i pozitave: Tri (3);

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i Institucionit;

Grada/Koeficienti: Koeficienti – 4.9

Orët e punës: 40 orë në javë;

Periudha e kontratës: Në kohë të pacaktuar;

Kohëzgjatja e punës provuese: Një vit (me mundësi vazhdimi)

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

Kopja e vërtetuar e përgatitjes shkollore;

Dëshmi për përvojën e punës;

Certifikata e lindjes;

Kopja e letërnjoftimit;

Vërtetimi që dëshmon se nuk është nën hetime;

Letër rekomandimet;

Certifikatën e gjendjes shëndetësore (pas pranimit të kandidatit në vendin e punës).

Kushtet për punësim:

Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;

Diplomë universitare , drejtimi bibliotekari

Fakulteti Filologjik – drejtimet Letërsi Shqipe dhe Gjuhë Shqipe;

Fakulteti Edukimit - Gjuhë dhe letërsi shqipe

Fakulteti Filozofik- drejtimi filozofi

Detyrat kryesore:

Bashkëpunon me udhëheqësin e institucionit arsimor në krijimin e strategjive dhe projekteve për bibliotekën e shkollës;

Bën kërkesa dhe jep rekomandime për pasurimin e bibliotekës së shkollës me tituj të mjaftueshëm;

Planifikon shfrytëzimin e fondit të librave nga ana e nxënësve;

Bashkëpunon në mënyrë aktive me mësimdhënësit e institucionit arsimor në motivimin e nxënësve për të lexuar në mënyrë të përhershme;

Mbanë raport të rregullt ditor, javor, mujor dhe vjetor lidhur me shërbimet e kryera;

Kryen detyra të tjera të caktuara nga drejtori i shkollës.

Afati i aplikimit

Data e njoftimit në web-faqen unike të procedurave të konkurrimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej datës **16.06.2023** deri më datën **15.07.2023**, ndërsa **koha e aplikimit** është nga data **17.07.2023** deri më datën **31.07.2023**.

Përveç web-faqes unike të procedurave të konkurrimit, konkursi publikohet edhe në web-faqen zyrtare të Komunës-<http://kk.rks-gov.net/podujeve> po ashtu edhe në tabelën e shpalljeve të objektit të komunës.

Mënyra e aplikimit

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund t'i marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në portalin për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). apo t'i shkarkojnë nga web faqja zyrtare e Komunës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve/> dhe të plotësuara t'i dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Podujevës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit dhe intervistave kandidatët do të informohen përmes njoftimeve të cilat do të publikohen në web faqen e Komunës së Podujevës dhe në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës, pas mbylljes së konkursit.

Drejtori: Avni Fetahu

